

BIBLIOTEKA
SHTETIT


8JH-1

M 36

Stefan Martikor

Daphnia
epari

vjersha



Stefan Martiko ka lindur në vitin 1948 në fshatin Përparim (Shënavasi) të Sarandës. Ka mbaruar teknikumin ekonomik dhe Shkollën e Bashkuar të oficerëve «Enver Hoxha».

Vjershat e para ka filluar t'i botojë që nga viti 1969.

Ky është libri i tij i parë.

D14-1
M 36

STEFAN MARTIKO

Dashuria e parë

vjersha



13292

FOTOGRAFIA

Babai qëndronte mbi supet tona lart,
ne-të futur nën harkun e supeve të tij;
sikur na ruante nga erërat
dhe erërat vetë i grumbullonte mbi qerpikë.

Muret tona të bardha nën korniza bojrash...
ç'na kujtohet gjithnjë i dashur babai.
Iku atë natë në istikamet e luftës;
neve na la muret dhe një heshtje të bardhë.

Ta kish marrë me vete këtë fotografi, —
të na shihte dhe një herë para se të binte;
fotografia t'i binte mbi plagë,
zemrat tona rreth plagësh t'i lidheshin;

ta kish marrë me vete këtë fotografi!
Ne nga fotografia mund të dilnim

oh, dhe mbi armikun, jo si fëmijë,
baba, si ti ne do të hidheshim.

Babai qëndronte mbi supet tona lart,
ne-të futur nën harkun e supeve të tij.
Sikur na ruante nga erërat
dhe erërat vetë i grumbullonte mbi qerpikë.

NË LINDJE TË KOMBINATIT METALURGJIK

Stina e parë që fusha nuk gjelbëron.

Gjithshka është në lindje.

U plotësuan dokumentat si në gjendje civile.

Montatorët vijnë përsëri
në breg të Shkumbinit.

Këtu

trenat do të fërshëllejnë për pesë vjet rresht.

Mijëra kokë do të zgjaten

nga dritaret e djersës.

Fushë dhe fushë,
nën malin Krrabë.

Ngrihen mbi fushë,
jo aeroplanët, —
këmbët e forta,
të furnaltave.

POL ELYARIT

Nga ëndrrat e tua
fluturoi një pëllumb me postën e paqes;
në udhë posta ra dhe humbi
nga sqepi i pëllumbit të përgjakur.

Pol Elyar,
pendët e arta po bien dhe paqja po bie;
re korbash të zinj
shushurijnë qiejve.

Na duhet të luftojmë prapë, Pol Elyar.
Miqtë e dikurshëm na u bën armiq;
rrugës mbetën si fragmente të të pathënave
pendët e pëllumbit bojëhiri.

Tani trajtën e një legjende mori paqja.
Këngët e tua hynë në vjeshtë.
S'e duam një paqe kur brenda saj
liria jonë si bora të tretet.

FËMIJËVE TË FUSHË-VËRRISË

Kënga e tyre më mbeti në zemër
si një pejsazh madhështor i shkëputur nga jugu.
E ndjeja kaq afër skenën,
zërat e tyre të ngrohta,
këpucët që i përplaste ai djal' i vogël
flokëverdhë,
duke hequr atë valle të moçme burrash.

Tabani i shollëve përplasej mbi skenat e
luft'rave
dhe kaq bukur s'do besoja të vinit ju, fëmijë,
në skenë,
dhe sikur një shkëmb nga Fushë-Vërria e
largët
këtu në skenë ju të kishit sjellë.

Në këtë sallë me kolltuqe

kam parë artistë të shkëmbenin dialogë,
të përlesheshin për një copë arë nga tokat e
Tuç Makut.

Dhe ju jeni kaq të freskët,
si ai bari që e duam përherë të gjelbër,
si ajo kënga që e duam përherë të
dashur.

MUZG

S'e harroj këngën,
në mozaikun e ngjyrave,
që la dielli mbi port.
Flamujt e direkëve valviteshin nga era...

Era detin si një qylym mbrëmjeje shtronte.

Porti i lundrueshëm
afrohej (apo më dukej mua)
afër Durrësit.
Dielli harxhonte filmat
mbi ca punëtorë,
që shkarkonin vaporët e fundit.

Dridhej në imagjinatën time
gjithshka,
dhe portreti i këtyre punëtorëve,
Kullonin në këtë çast ngjyrat
në këtë kryqëzim të pandërprerë reflekto-
rësh.

Punëtorët ikën.
(Ç'morën me vete punëtorët, duke ikur?)
Ndjeva lokomotivat mbi shina, gulçimën e
tyre,
shpejtësinë e sekondave.
biseda dhe tinguj.

LENINI

Transportonin bustin e Leninit
në frontet e luftës ushtarët.
Në pushimet e shkurtëra,
pas betejave,
i lidhnin bustit plagët.

Kur plagoseshin ata
me ta plagosej dhe busti.

TOKA E FSHATARËVE

Ata kishin mbi kokë
çatinë dhe qiellin,
qiellin që bëhej ato net i bukur e më i
bukur,

me yje të largët
si komça sedefi;

ata dilnin netëve te praqet
dhe shihnin me mall tokat;
vinin me hapa të gjatë
nga luftërat e lirisë dhe bukës,
reformat.

Vinin gëzimet me kuaj të bardhë
dhe ndanin tapitë.
Gjumj s'i zinte netëve fshatarët.
Ato net,
pranë tokave i gdhinin.

Tokë, tokë, tokë...

Ishte toka që në vite-ehu, sa vite të
gjata! —

e lëruan me lot.

Erdhën nga qarku shokët që bënë luftën,
erdhën dhe ndanë tapitë.

Fshatarët vinin duart te ballët e rrudhur
... U digjnin sytë.

Tokë, tokë, tokë...

Si vallë, shkuan këta vjet!

Nga oqeane të dhimbshme errësire
në brigjet e kohërave dolën.

* * *

Pranvera lëvizi,
si zogu në vezë lëvizi.
I ngrohu ditët e tij të fundit,
në çastet e ikjes,

dimri.

Pranvera jep pritje shirash e diejsh.

MIKELANXHELO

Aq u entuziazmua Mikelanxheloja para Moisiut
sa i ra me çekiç dhe i tha «folë»!

Ç't'i thoshte statuja e bardhë Mikelanxhelos,
«Mos, Mikelanxhelo, mos»?!

I kishte dhënë sytë e zemrës
statujës së bardhë Mikelanxhelua,
prandaj priste të shihte Mikelanxhelon,
në sytë e statujës, Milanua.

Mikelanxhelua mbeti vetë statujë,
megjithëse veten s'e gdhendi kurrë.

DASHURIA E PARË

Ke parë në sytë e mi
diellin e jugut si lind nga majat
e perëndon mbi det;
ke parë dashurinë që u nis
me autobuzin e bardhë të rivierës.

Shatërvane ka në jug,
jo si shatërvanet e mahnitshme të Bahçesarajt,
por dhe këtu ujërat derdhen,
nën gjelbrime të pazverdhura
portokajsh.

Do të të marr me vete në jug,
kur malet bojëhiri të mbrëmjes
lidhen një me horizontin e largët.

Andej, si në minierat e arit,
nxjerr muzgu i detit ngjyrat e mbrëmjes.

Eh, dashuria! . .
Tërë elektricitet si dy pole, dashuria.
Ka korrente të fuqishme në jug,
e dashur.
Erërat çdo mbrëmje këtu shkëmbejnë vizita.

Po vijnë ujërat e lumenjve te limonat. . .
Buron dashuria e njerëzve nga toka.



17

13292

KORRIERI I BATALIONIT

Ke marrë me vete një plumb,
po ti rend e rend e rend;
një copë metali të ftohtë si një varr
të djeg, të tërheq drejt vdekjes.
Për ku vrapon korrieri i batalionit?
Rruga është e gjatë,
rruga është e gjatë. . .

Ku shkon, ku shkon korrieri këmbëshpejtë?
Mos qenka thënë, mos qenka thënë
të biesh me dorën pranë letrës dhe plagës?

T'u tret shikimi i syve
mbi udhët që zgjatëshin monopateve,
gërxheve.
S'u shuan sytë, u shuan dy llamba,
ndërsa drita vazhdonte udhën për te shokët.

PIKËTAKIME

Këtu ikin trena,
këtu takohen trena,
vetëm një gjuhë kanë trenat,
trenat bisedojnë me gjuhën e sirenave

edhe kur ikin edhe kur vijnë,
edhe kur sjellin mineral nga malet.
edhe kur sjellin të dashuruarit,
edhe vajzat nga plazhet.

Sa herë, i ndodhur në pikëtakimet e trenave,
desha të isha thjesht konduktor,
që pret e nis trena, vazhdimisht trena,
trena mineralesh dhe trena luksoze

dhe në pak minuta të isha tranzit
i të gjitha dashurive.

Në Butrint-e vetme Dea.
Kushedi në ç'zjarr u ngroh
derisa mbi të u vërtitën të pamëshirshme
flakët
dhe koka e saj e mbështjellë mbeti
nën muzgjet e qiejve të lashtë.

Dea, kush të thirri sonte vonë nga Butrinti?
Fenerë të vegjël,
si pika inkadeshente në horizontin e deteve,
rreth bardhësisë sate ndizeshin.

Në ato vija të bukura buzësh e sysh
ti pararende drejt kohrave, Dea.
Asnjë rrudh' në ball,
e freskët, e qetë,
ti prisje tufanet e ftohta të erërave.

Dhe mbi gjoks,
duart e jetës,
ranë e u ngrohën tek ti,
tek ti, Dea, që s'thua,
si kalove e heshtur pranë shekujve,

Dea, moshatare e perëndive.

KUR HAPEN PLAZHET

Erdhi përsëri stina e plazheve,
punëtorët montojnë tani kabinat,
mbi rërën e ftohtë ngulin
afishet e freskëta të stinës.

Erdhi stina e plazheve
dhe deteve ngrohet rëra.
Në kabinat me fibër
janë inçizuar fragmente puthjesh.

Dhe gjurmat tona me peshën e njohjes
do të dalin nga thellësia e rërës.

MOHIMI I PARAJSËS

Arkeologu hapi derën e varrezës:
ftohtësi e shekujve, metamorfozë klime;
hapi derën e rëndë;
lashtësi brenda varreve, dhe stolive.

Arkeologu ndjeu frymëmarrjen e metaleve.
Metalet e ftohta
i pëshpëritën gjuhën e gjermave.
Brenda jetonin skllavopronarët me bijtë
në varrezat hermetike të ëndrrave.

Jashtë i vranë skllëvërit,
skllëvërit në të ftohtë i lanë jashtë;
ndërsa u premtuan në urdhërin e perëndive
dhe u mohuan parajsën.

Arin e rëndë peshoi në duar arkeologu,
por koh'rat s'i mat dot me peshën e arit;
vështronte i ngrysur arkeologu;
vështrimi i mbeti mbi varret.

NË BOROVË

Qielli është fiksuar mbi monument;
ka re dhe shi qielli nga dimri që shkoi.
Re. Ndoshta kështu ishte qielli atë ditë në
Borovë,
kur erdhën gjermanët dhe filluan të hanë
trarët e kasolleve tona.

Lart, si në piktura,
qielli nxinte,
qielli mbi Borovë derdhte shi.
Flakët zinin qiellin,
me duar, si fëmijë.

Tani është pranverë e
vogëlushët e Borovës erdhën te monumenti.
Ç'menduan vallë vogëlushët e Borovës
shtrënguar fort pas njëri-tjetrit?

Si vetëtimë
çajnë qiejt krahët e mermertë.

NË ËNDËRR

Fryjtën erërat dhe hapën
kanatet e dritareve të tua mbrëmë.
Ti në gjumë fluturoje
me buzëqeshjen tënde
mbi një ëndërr.

I dërgova erërat të të sillnin
fjalët e mia.
Unë, te pezuli i dritares,
erërat nga gjethet e verdha i fshija.

Erëra të dashura, erëra...
vijne tek ti,
të ledhatojnë ballin,
të dallgëzojnë leshrat.

ULLINJTË

Zbres sonte me zërat e natës te ullinjtë,
te ullinjtë që flenë nën gjelbërim,
ullinjtë që në shekuj na i vranë,
që në shekuj nga vdekja i ngritëm.

Kur vijnë nga Mesdheu
stinët e ngrohta,
nëpër degët e tyre nxijnë
pa u kuptuar

kokrrat.

Kokrrat e zeza me ndriçim të artë
varen si yje nëpër degë,
dridhen nëpër gjethe.
Në shekuj, në trungjet e tyre të lashta
herë thamë një këngë,
herë thamë një brengë.

Sonte fryn erë e detit,
era e ngrohtë e ullinjve.

Ë NESËRMJA E TIJ

Kush vinte kështu, nëpër ëndrra duke trokitur,
me tyta pushkësh te oborret,
ndërsa ai po merrte në gjumë
udhët e thella të katakombave?

... I ngritën trikëmbështa dhe e varën...
Me sytë e egër, si dikur,
kërkoi prapë jetën e fshatarëve...

Papritur u zgjua.
Ishte gjumi i fundit
në dyshekun me pupla.

Qielli u ul mbi male i kaltër.
Kuajt hanin nën yje misër me xhufa.
Ai dridhej
në krevatin me pupla...

Kish mbaruar lufta.

Pa me llahtar një dritë, që depërtonte mes
perdeve,

dhe klithi:

«Grua, grua
përmbytje!»

E RE DHE E LASHTË

Ja, e dashur, mbi këtë mur të lashtë
qëlluan me topuz legjendat.
Bajlozët e tmerrshëm të detit
vështruan egër nën bedenet.

Këtu, nën këto mure,
sa herë u zverdhën barërat pa dritë.
Poshtë fle qyteti i lashtë:
Se ç'gjumë bën,
as ti as unë nuk e dimë.

Flenë
dhe muret dhe bedenet nën lashtësi.
Sipër dritat e bardha të mbrëmjes
burojnë mozaikë kaltërsish.

Nën këmbë trokojnë për tek ne shekujt dhe
luftërat.

Ne e dimë
sa peshojnë
qytetet e lashta
në hartat e arkeologëve.

Ndizen dritat poshtë nga qytetet,
sipër reflektojnë neonet e muzeut.
Ne me sytë nga bota e madhe e njerëzve
peshojmë sonte
gjithë lavdinë e bukur të shekujve.

KUJTIM

Gjyshit tim të vranë nga gjermanët

Ushtarët e huaj në natyrë të vranë,
të vranë me plumba.
T'u duk atë çast se u shkundën pemët e
vjeshtës
nga ngarkesa të lumtura.

Ke kohë që rri nëpër ara
e në mbrëmje
vjen me hapa të matura,
duke ndjerë mbi supe
ndryshimin e vazhdueshëm të stinëve.

Vjen i mbushur me ajrin e mbrëmjeve
dhe tokave,
vjen e nga malli
do të përplasësh një gotë te sofa;

vjen e ikën vetë,
herë me zemërim, herë me dhembje —
ritmi i hapave të tua
te dashuria jonë troket, troket.

ÇAST

Fjetoret heshtën pas zhurmave të mbrëmjes.
Ti në heshtje sikur zbërthen diçka ngadalë, —
ndoshta jetën tënde që erdhi deri këtu e qetë
dhe dashurinë që si enigmë t'u shfaq.

Dashuria e panjohur dhe e bukur erdhi
që nga sytë,
që nga zemra.
Ndaj sonte flasin telefonet të gëzueshme,
yjet, pemët
me mijëra e mijëra.

Fjetoret heshtën
por ti s'bën sonte gjumë;
ti shkarkon dhe ngarkon në zemër
ditët e lumtura që do vijnë.

LEJLA MALO NGA DELVINA

Jo, për ty kjo natë s'shuhet,
moj Lejla, moj motra ime.
Përmbi rrugët e Delvines
bien gjethet e ullinjve. . .

Dhe vitet ujëra krojesh shkuan
të lagin flokët nëpër re.
Ne yjet kurrë s'na u ndanë,
Lejla moj motër, ti s'u ndave.

Dhe nata shkon dhe nata ikën.
Mbi gjurmë yje të zbret nata.
Ti mbuluar krejt me yje
nën borzilokë e manxurana.

BISEDË NË LUFTË

Vure receptorin në vesh,
dëgjomë!
Njëmijë hektarë grurë,
njëmijë hektarë na u dogj.

Dëgjomë !
Buka na u dogj. . . ranë predha me
helm.

Gruri binte në këmbët tona,
digjej gruri i pjekur.

Dëgjomë !
Bukën na e dogjën,
hodhën predha me shi.
Zjarri i verdhë
dogji tokën.

Ç'është ky pyll, bir,
në Amerikë?

Kafshë as në xhunglat tona
si këto s'riten.

Dëgjomë !
Tek ata
s'paska më
asgjë prej njerëzve.

ROJTARI I QYTETIT TË LASHTË

Në dhomën e tij ndrit llamb' e vetme,
në dhomën e tij ka qetësi.
Formularët me emrat e gjithë perëndive
bëjnë një gjumë të rëndë.
përmbi tavolinë.

Pyet plaku me vete...
Kohërat mbetën prapë të paqeta
edhe pse inatin e perëndive
shekujt e ndrydhën
në këto statuja të heshtura.

PRITJE

Erdhëm këtu, buzë detit
dhe deti papritur na ngriu në sy.
Ç'ishte kjo? ! Na priste deti
me ovacionet e shpërthimit të tij.

LEGJENDA E DASHURISË PRANË DETIT

«Mua më harrove fare, ç'zemër ke...»
Ku t'i gjej fijet e kësaj kënge,
shpleksur nëpër degët e mandarinave?

«Mua më harrove fare;
ç'zemër ke?...»
Mua vajzë e viseve të Jugut
vetëm pse më le?

Gjithë ngjyrat e tokës dhe detit
vraponin drejt mbrëmjes.
Ndërsa këndoja këngën e dashurisë sonë,
vije tek unë si diçka e dashur e dridhshme.

E kuptova;
kaq të pashpresë në një pritje të pafund,
në një pritje të gjatë
dikur e la të hidhëruar djalin
vajza e një tragjedie trazuar me dallgë.

Unë e kuptova,
ti vije drejt meje;
vinin me mijëra vajza.
Dashuritë e tyre
si erëra të pikëlluara frynin.

Ato vajza të bukura,
që mbetën dikur pa dashuri,
sonte kanë mall e dalin nga legjendat,
kujtojnë të humburën, të paarrirën vajzëri.

NËNTËDHJETË VAJZA

Ranë nga shkëmbi i Vajës si zogj të bukur
në detin e një tragjedio të dhimbshme.
Gulçonin dhe erërat
dhe shirat
dhe vetëtimat.

Shkëmbi i Vajës
përballë maleve —
nga iku drejt kohërave
heroizmi i pashembëllt i vajzave krutane.

* * *

Në u bashkofshim. . .
Seç kam ca parandjenja,
sikur atë ditë gjithë zogjtë
do të shndërrohen në pëllumba.

Seç kam ca parandjenja
aq të gëzuara dhe të bukura, Bardha.
Qielli atë ditë më duket sikur do të zbresë
te gëzimi ynë si një sofër e madhe
dhe gjithshka do të jetë pranë nesh
sepse gjithshka afrohet në festë.

* * *

Për Zaho Kokën

Këngë himarjote,
mbi shtratin tuaj të ngrohtë më shkoi
fëminia;
prilli i blerimeve vinte majave
me borëra të shkrira.

Mbi rreshta ullinjsh shkonin këngët.
Prapë të dridhet zëri nga malli për
Zaho Kokën:
e deshi aq shumë toka komisarin,
e deshi aq shumë komisarit tokën.

Dhe ngrihej në fëmininë time komisarit;
batalionet të papërmbajtur luftrave...
«bënin fjalë».

Zaho, Zaho, «Vetëtima»,
shtruar je në këngë;
këngët zgjaten brenda zemrës.
Me një thirrje të zgjatur të kërkoj,
komisari ynë o trim.

GJYSHE, GJYSHE

Përmes kopshteve, ku lulzojnë pemët,
ti s'do shkosh më e gëzuar, gjyshe.
Ligji i jetës është i rreptë.
Ti rrojte mes njerëzve
dhe një ditë
mbylle sytë e ike mes tyre.

Ti ike e lumtur, —
gjelbërimi kundërmonte në filiza
gjethesh.

Nipërit të thërrisin,
po ti vure kokën mbi jastëk
dhe më s'do të kthehesh.

E ja tani prapë, në shtëpi,
në bisedë ti do të futesh prapë.
Flokëthinjura moj gjyshe,
nga malli i zemrës
prapë të thërras.

JETË DHE VDEKJË

Motiv Vietnamez

Nën qiej aviona
mbi qytete aviona,
pista të zhurmshme
aerodromesh.

Aviona US ARMY
ngarkojnë vdekjes në Amerikë
dhe hedhin bomba
dhe vrasin jetën
vrasin fëmijët.

Vdekja e mbledhur në ato bomba
të rënda

bie sonte diku
nga US ARMY e bardhë,
nga metali i ftohtë i luftës.

Jeta shpërthen nga tytat e nxehta të
armëve.

Qëllojmë qiellin e vdekjes
dhe pranë një mëngjezi fëmijë të
gëzuar

rifillojnë jetën.

MOTIV DERADJAN

Serafinë, lamtumirë!
Bozdari iku midis valëve;
ai iu lut që gërshetat t'i plikste
si pendët e lumbardhave.

I përzënë, po iki, Serafinë.
Tingulli i njohur më s'do më kthejë.
Çangat do të bien me ngulm
mbi mua, të dëbuarin e shkretë.

Botën mos m'a le të shkretë.
Në sytë e tu dua të shoh botën
dhe më pritë, se çdo ditë, Serafinë,
duke mposhtur dhëmbjen, mall do të
dërgoj.

• • • • •
Por anije s'erdhi në molo
«Sa ajo më e re s'dukej».

Ëra rrahu ëndrrën e saj,
era i dërgoi, si dëshpërim, këngët.

S'do të vijë më Bozdari;
valët thanë s'do të vijë;
prandaj sot, kur çel bajamja ndan' detit,
thonë çeli vajza Serafinë.

JETË E PAMBARUAR

Dëshmorit S. Kosturi

Ç'janë këto hapa, ç'janë këto këmbë,
ç'tringëlljnë natën vonë zinxhira?
Qytet i heshtur duket se fle —
mbi kokë, e zezë si kupolë, —
hapësira.

Po ti s'fle. Sytë e plagëve janë hapur
dhe rrjedhin gjak,
në sytë e ballit
i ndrydhe dhembjet e plagëve prapë.

Plagë të hapura, kamzhikë dhe zjarr.
O, ai s'fle, diçka po ëndërron;
plagët janë vatra të përgjakura
dhe ushtri e huaj mbi to po kalon.

Ç'ëndërron kështu, ç'ëndërron kështu?
Mbi gjakun tënd do ngrihen qytetet.
Me hekurat e qelive do të bëjmë
betonin e pavdekshëm për monumentet.

ZEZAKJA E VOGËL

Mos qaj, vogëlushe, mos qaj.
Ç't'u them syve të tu që vezullojnë nga lotët?
Kë kërkon, vogëlushe, kë kërkon
me sytë e tu mbushur si një gotëz?

Ti mbete pa nënë, vogëlushe.
T'a mbytën nënën racistët.
Ti vetëm me duart e tua të vogla na thua
aq shumë, sa s'na thonë dot të gjithë
grataçielet.

Për ku ecën, vogëlushe, nën këto male
pallatesh,
për ku sonte, për ku si një yll i harruar?
Ti na shfaqesh çdo mbrëmje e ne të shohim.
Drejt teje të të merrja i ngrita sonte duart.

ROSAT IKËN

Mbetën gjahtarët
me çiftet plot:
Iknin në një perëndim
të largët rosat.

Hyjnë traktorët në Tërbuf,
hyjnë rosat në qiell,
tokën gjelbëroi gruri.
Po qielli?
vetëm shtegëtime.

Hynë fshatarët në Tërbuf,
korrën grurin.
Rosat
më s'u dukën;

rosat më s'do të vijnë:
u bënë shpend të qiellit;
mbi Tërbuf traktorët
lërojnë stinët.

GURË

Kala e Kaninës,
kala e pambaruar e Kaninës,
ç'do të vendosin akoma mbi ty ushtarët?
Ndoshta gurët që s'patën vinça t'i
ngrinin?

Sa linin pushkët, rrëmbenin mistritë,
Ç'mbeti pa vënë akoma mbi kala?
Ra mbi të
dhe mbuloi heshtjen mjegulla.

Kështjella ka mbetur
si një sy i madh nga deti.
Brenda saj kaq shumë kaltërsi
u harxhua vazhdimisht në predha.

Mbetëm këtu, me sy nga Kanina...
Na vijnë ndër mend, të heshtur, ushtarët;

supet e tyre si supet e atdheut,
kockëdalë dhe të përgjakur.

Kështjella ka mbetur dhe vështron
si një sy i madh nga deti.

FRYN ERË

E shoh,
e ndjej...
Kjo erë që fryn
po shkallmon dyert e burgjeve të
kapitalit.
Dëgjoj klithmat e fëmijëve që shkojnë
natën,
mbështjellë me pelenat e së ardhmes.
Mbi ballin e kontinenteve
mbështetin kryqin e ftohtë apostujtë.

Po frynë erë,
bubullon;
vetëtimat, si harqe të çmendura,
po ndajnë netët, epokat, më dysh.
Po fryn erë.

Dhe prapë

popujt shtrydhin rrobat e lagura nga
demonstratat

dhe prapë përmes barikadave
ngrenë pranverën —
flamurin që fluturon mbi metropolet.
Popujt
predhave për betejat e ardhshme
u vënë djegoret.

Dhe mijëra topa
dhe mijëra flamuj
ngrenë pranverën, ngren' lirinë.
Po fryn mbi botë kjo erë e marrë,
ngre fletët e rrugëve,
rrëzon çatitë.

Dhe bien e bien,
nën këmbët e popujve, komplotet,
si letra të djegura.
Dhe ngrihen popujt dhe ngrihen popujt,
me flamuj të shpalosur,
në një mëngjez të bukur e të madh.

Fryn era e armëve.
Metropolet lëkunden.
Kjo erë s'mposhtet,
është era jonë,
o popuj dëgjoni, o popuj dëgjoni.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Fotografia	3
Në lindje të kombinatit metalurgjik	5
Pol Elyharit	6
Fëmijëve të Fushë-Verrisë	7
Muzg	9
Lenini	11
Toka e fshatarëve	12
Pranvera lëvizi	14
Mikelanxhelo	15
Dashuria e parë	16
Korrieri i batalionit	18
Pikëtakime	19
Dea	20
Kur hapen plazhet	22
Mohimi i parajsës	23
Në Borovë	24
Në ëndërr	25
Ullinjtë	26
E nesërmja e tij	27
E re dhe e lashtë	29
Kujtim	31
Çast	33
Lejla Malo nga Delvina	34

	Faqe
Bisedë në luftë	35
Rojtari i qytetit të lashtë	37
Pritje	38
Legjenda e dashurisë pranë detit	39
Nëntëdhjetë vajza	41
Në u bashkofshim	42
Këngë himarjote	43
Gjyshe, gjyshe,	45
Jetë dhe vdekje	46
Motiv deradjan	48
Jetë e pambaruar	50
Zezakja e vogël	52
Rosat ikën	53
Gurë.	54
Fryn erë	56

Redaktor: **Pandeli Koçi**

Kopertina nga: **Svetllana Strazimiri**

Tirazhi 2.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204 - 72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1973